



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	qershor 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **qershor 2017**, në **6** zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **3,458** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **3,399** kërkesa, refuzuar **10** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **88** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Në Drejtorinë e Kadastrit gjatë muajit **qershor** 2017, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve të Drejtorisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme.

Në Sektorin e kadastrit janë shqyrtuar kërkesat në vijim:

- 297 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 232, refuzuar 6 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 59 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 15 kërkesa për historiata, nga persona fizikë dhe institucione, prej të cilave janë miratuar 11 dhe 3 kërkesa kanë ngelur në procedurë;
- 267 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe janë realizuar të gjitha;
- 28 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë miratuar 17, janë refuzuar 2 dhe 9 kanë ngelur në procedurë;
- 1 kërkesë për lirim nga barra tatimore, e cila është miratuar;
- 84 kërkesa për regjistrim të hipotekave, të gjitha të miratuara dhe 44 kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë miratuar 43 dhe 1 është refuzuar.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranura për këtë sektor ka qenë: 909, nga të cilat 828 kërkesa janë miratuar, 9 janë refuzuar dhe 71 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 1,417 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 900 kërkesa për kopje të planit, që nënkupton se janë pranuar dhe realizuar 2,317 kërkesa;
- 24 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar 26 dhe 4 janë në procedurë, ku 6 prej tyre janë nga muaji i kaluar;
- 8 kërkesa për incizim të ndërtesave, nga të cilat 7 janë miratuar dhe 1 ka ngelur në procedurë;
- 10 kërkesa për bashkim të parcelave nga të cilat janë aprovuar 10 dhe 1 kanë mbetur në procedurë, nga të cilat 1 janë nga muaji i kaluar;
- 49 kërkesa për dhënie e produktëve (koordinatave) - të realizuara të gjitha 60, nga të cilat 11 janë nga muaji i kaluar;
- 35 kërkesa për identifikimin e njësisë banesore nga të cilat janë aprovuar 38 dhe 3 kanë ngelur në procedurë, nga të cilat 6 janë nga muaji i kaluar;
- 20 kërkesa për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 20 dhe në procedurë kanë ngelur edhe 3 kërkesa, ndërsa 3 kërkesa janë nga muaji i kaluar;
- 2 kërkesë për ndërrim kulture, e aprovuar 1 dhe e refuzuar 1;
- 71 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 78 dhe 4 kanë mbetur në procedurë për shqyrtim, nga të cilat 11 janë nga muaji i kaluar;
- 13 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat 1 kërkesë ka ngelur në procedurë dhe të tjerat janë miratuar.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuarra për këtë sektor ka qenë: 2,549, nga të cilat 2,571 kërkesa janë miratuar, 1 është refuzuar dhe 17 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka realizuar rreth **90** për qind (%) të planit të saj, duke i miratuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej **5** ditë punë, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësisive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat perkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, qershor 2017	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë & Kopje të planit	2,317	2,317	0	0	10,986
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	297	232	6	59	11,300
Kërkesa për historik - zyrtare, historik për persona fizikë dhe juridikë	15	11	0	3	150
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	267	267	0	0	97
Përmirësime në RDPP	28	17	2	9	560
Lirim nga barra tatimore	1	1	0	0	10
Barra tatimore	0	0	0	0	0
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	84	84	0	0	8,370
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	44	43	1	0	440
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj.	173	173	0	0	140
Ndarjet - parcelizimet	24	26	0	4	5,620
Incizimi i ndërtesave, banesave	8	7	0	1	3,420
Bashkimi i parcelave	10	10	0	1	990
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	49	60	0	0	1,365
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	35	38	0	3	700
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	20	20	0	3	800
Ndërrim i kulturës	2	1	1	0	3,263
Plotësim pagese - gjeodezi	0	0	0	0	0
Kërkesat me licencë	71	78	0	4	4,171

Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	13	14	0	1	45
Gjithsej	3,458	3,399	10	88	52,427

4.1.2 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese*

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 *Takimet me palë*

- **Sektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*të martave dhe të enjteve*) nga 2 orë në ditë me dy zyrtar ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 3765 qytetarë.
- **Sektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë, ku gjatë muajit maj ka pranuar 246 palë për plotësim të lëndëve, sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. *Takimet me institucione të tjera.*

- **Sektori i kadastrit** ka pasur takim me qytetarë për çështje të ndryshme kadastrale – pronësore, për të cilat kemi gjetur zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t’i drejtohen institucioneve të tjera në vend. Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyera nga kjo Agjenci.

5.1.1 *Diskutime publike/takime me qytetarë* - Nuk kemi pasur.

6. *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

6.1.1 *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.*

- **Sektori i kadastrit:**

- Lëndë të pranuar: 909
- Lëndë të miratuara: 828
- Lëndë të refuzuara: 9
- Lëndë në procedurë: 71

- **Sektori i gjeodezisë:**

- Lëndë të pranuar: 2,549
- Lëndë të miratuara: 2,571
- Lëndë të refuzuara: 1

- Lëndë në procedurë: 17

7. **Takime të tjera - nuk ka pasur..**

8. **SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Sektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, mosdhënia e përgjigjeve nga ana e tyre në afate ligjore të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 6 kërkesa presin për verifikime ne Arkiv Komunal dhe Nderkomunal;
- 153 kërkesa presin për verifikime në Gjykatë;
- 10 kërkesa persin për verifikime në privatizim;
- 14 kërkesa presin për verifikime në NPB;
- 14 kërkesa presin për verifikime ne KPA;
- 3 kërkesa presin për verifikime ne Drejtorinë e Financave dhe Pronës.

Sektori i gjeodezisë:

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mosdhënia e përgjigjeve nga ana e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin “CadastralMap” dhe SITK të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastral e Kosovës.

9. **REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

Sektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Sektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të Kornizës së punës.

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.*

Spektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Spektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisve banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*